EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6472
E mërkurë, 24 nëntor 2021
çmimi 0.40 €

Kurti: Austria dhe Kosova kanë lidhje të forta historike

FAQE 3

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

TË MARTËN KANË HUMBUR JETËN 46 PERSONA DHE 7 TË TJERË JANË LËNDUAR NGA NJË AKSIDENT TRAFIKU NË BULLGARI FAQE 4-5

46 VIKTIMA NGA AKSIDENTI TRAGJIK NË BULLGARI, SHUMICA E TYRE SHQIPTARË

- Maqedonia e Veriut shpall tri ditë zie kombëtare për viktimat e aksidentit në Bullgari

Maqedonia e Veriut dhe shqiptarët janë tronditur të martën nga lajmi për vdekjen e 46 personave nga djegia e një autobusi në autostradën Struma të Bullgarisë. Mësohet se viktimat janë shqiptarë, ndërsa në mesin e tyre janë edhe 12 fëmijë.

Autoritetet bullgare dhe maqedonase kanë bërë me dije se shkaqet e aksidentit janë duke u hetuar. Dyshimet e para janë se zjarri ka shpërthyer pasi autobusi ka goditur parmakun mbrojtës të autostradës. Nga aksidenti kanë shpëtuar 7 persona, të cilët kanë arritur të largohen nga autobusi dhe gjendja e tyre është stabile. Për këtë aksident tragjik ka pasur reagime edhe nga liderët e Kosovës dhe të Shqipërisë, të cilët janë shprehur të tronditur nga kjo ngjarje

IKD-ja: MUNGESA E LLOGARIDHËNIES SË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE, PENGESË PËR AVANCIMIN E SISTEMIT TË DREJTËSISË

PARAQITET PROJEKTI 'LAW DATA', SYNON FUQIZIMIN E TRANSPARENCËS SË KUVENDIT

AKTUALE

KQZ-ja CERTIFIKON REZULTATET PËRFUNDIMTARE TË RAUNDIT TË DYTË TË ZGJEDHJEVE F. 3

ABBOTT: RAPORTET ME KOSOVËN JANË TË FORTA DHE NUK DO TË NDRYSHOJNË F. 7

RAPORTI 24-ORËSH I MSH-SË: 15 RASTE TË REJA ME COVID DHE 2 449 TË VAKSINUAR F. 6

RREZIKU NGA MINAT NË KOSOVË ËSHTË ENDE REAL F. 6

EKONOMI

PROTESTOJNË PUNËTORËT E "FERRONIKEL"-it, KËRKOJNË TË RIKTHEHEN NË VENDIN E PUNËS F. 8

PROJEKTLIGJI PËR INSPEKTIMET PËRPLAS POZITËN ME OPOZITËN F. 8

SPORT



NUHIU DHE HAXHIMUSA KËRKOJNË FITORE NË DERBIN NDAJ GJILANIT F. 10

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Shtëpia e Bardhë: Bideni synon të garojë sërish më 2024

UASHINGTON, 23 NËNTOR - Shtëpia e Bardhë ka thënë se presidenti amerikan Joe Biden synon të garojë sërish për president më 2024.

Zëdhënësja Jen Psaki u ka thënë gazetarëve se rikandidimi është synim i tij. Ajo i ka bërë këto komente në aeroplanin presidencial teksa Bideni është nisur për të marrë pjesë në një organizim me trupat amerikane për Festën e Falënderimeve.

Javën e kaluar demokrati 79-vjeçar i është nënshtruar një ekzaminimi fizik, njëherësh të parin prej kur ka marrë detyrën e presidentit në janar të vitit 2021.

Mjekët kanë thënë se ai është i shëndetshëm për t'i kryer detyrat e tij. Mbështetja ndaj Bidenit ka rënë në muajt e fundit, çka ka nxitur pyetje nëse ai është i gatshëm për të garuar për një mandat të dytë. Një president amerikan mund të mbajë dy mandate katërvjeçare.

Republikani Donald Trump, 75-vjeçar, i cili është mposhtur nga Bideni në zgjedhjet presidenciale të vitit 2020, nuk është deklaruar publikisht nëse do të garojë sërish.

Amerika shpall terroristë tre liderë të IS-K

UASHINGTON, 23 NËNTOR - Departamenti Amerikan i Shtetit (DASh) ka njoftuar se ka shpallur terroristë tre liderë të degës së grupit militant, Shteti Islamik në Afganistan (IS-K). Në një deklaratë të publikuar nga ky departament është thënë se tre anëtarët janë shpallur të tillë sipas aktit për terroristët globalë. Aty, po ashtu, është thënë se një tjetër person është sanksionuar nga Departamenti Amerikan i Thesarit meqë ka ofruar ndihmë financiare për IS-K. "Shtetet e Bashkuara janë të përkushtuara për t'i përdorur të gjitha mjetet kundër terrorizmit për ta luftuar kërcënimin që vjen nga Shteti Islamik Korasan dhe për t'u siguruar se Afganistani nuk do të bëhet më platformë për terrorizëm ndërkombëtar", ka njoftuar DASh-i.

Në mesin e të shpallurve terroristë është edhe Sanaullah Ghafari, i njohur edhe si Shahab al-Muhajir, i cili është identifikuar si "emiri aktual" i IS-K.

Në deklaratë është thënë se ai është emëruar në këtë pozitë në qershor të vitit 2020 dhe se është përgjegjës për miratim të të gjitha operacioneve të IS-K në Afganistan. Dy personat e tjerë janë Sultan Aziz Azam dhe Maulawi Rajab.

Dega e IS-it në Afganistan ka shtuar sulmet prej kur talebanët kanë marrë pushtetin në këtë shtet, në gusht të këtij viti. Talebanët nuk kanë arritur ta ndalin zgjerimin e këtij grupi i cili tani duket se është gati në të gjitha provincat. Numri i sulmeve që i është atribuuar grupit është rritur nga 60 vitin e kaluar, në 334 këtë vit, kanë thënë zyrtarët amerikanë.

Bjellorusia po kthen emigrantët në vendlindje

MINSK, 23 NËNTOR - Ministria e Brendshme në Bjellorusi ka thënë se 118 emigrantë janë larguar nga shteti më 22 nëntor dhe më shumë do të mund të dëbohen më 23 nëntor, ka raportuar agjencia ruse e lajmeve, TASS.

Bashkimi Evropian ka akuzuar Bjellorusinë se është duke marrë mijëra gra, burra dhe fëmijë nga Lindja e Mesme dhe është duke i shtyrë drejt kufijve të Bjellorusisë me Poloninë, Lituaninë dhe Letoninë si përgjigje ndaj sanksioneve të bllokut evropian për shtypjen brutale të protestave, në të cilat lideri autoritar Akyaksandr Lukashenka është akuzuar se ka manipuluar zgjedhjet e mbajtura në gusht të vitit 2020. "Vetëm dje 118 persona janë larguar nga aeroporti kombëtar i Minskut dhe ky aksion është duke vazhduar sot. Këta 118 persona janë larguar individualisht. Mekanizmat për punë të brendshme dhe trupat kufitare u kanë ndihmuar për dokumente", është cituar të ketë thënë ministri i Brendshëm, Alyaksey Begun.

Ai ka thënë se asnjë emigrant nuk ka aplikuar për azil në Bjellorusi. "Një grup i shtetasve të huaj është ende në Aeroportin Kombëtar të Minskut sot, ka kaluar të gjitha procedurat kufitare e doganore dhe është duke pritur për t'u kthyer në shtetin prej nga e kanë shtetësinë personat në të", ka thënë Begun, pa specifikuar vendin.

Shumica e emigrantëve kanë shkuar në Bjellorusi nga vendet e shkatërruara nga konflikti si Siria, Iraku dhe Afganistani.

Kina regjistron shkallën më të ulët të natalitetit në katër dekada

PEKIN, 23 NËNTOR - Në Kinë shkalla e natalitetit ka rënë në nivelin më të ulët në më shumë se katër dekada. Zyra e Statistikave ka thënë se më 2020 është vërejtur rënie prej 18-përqindësh. Për pasojë janë regjistruar 12 milionë foshnja, kryesisht për shkak të pandemisë. Mirëpo ekspertët kanë vënë në pah edhe faktorë të tjerë si çmimet e larta të jetesës, edukimi, kujdesi shëndetësor dhe mosgatishmëria për t'u martuar. Shkalla e natalitetit në vendin me popullsinë më të madhe në botë ka rënë në numër njëshifror për herë të parë prej vitit 1978, pasi 8.52 foshnje janë regjistruar për 1 000 banorë. Për shkak të numrit në ulje të lindjeve dhe numrit stabil të vdekjeve, Kina është duke shkuar drejt stagnimit të popullsisë.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Paraqitet projekti ‘‘Law Data’’, synon fuqizimin e transparencës së Kuvendit

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 NËNTOR - Në Kuvendin e Republikës së Kosovës të martën është paraqitur projekti “Zhvillimi i shërbimit informativ ligjor (Law Data)”. Qëllimi i këtij projekti, financuese e të cilit është Ministria e Jashtme e Norvegjisë, është fuqizimi dhe promovimi i transparencës dhe efikasitetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës si dhe institucioneve të tjera shtetërore të sundimit të ligjit në Kosovë.

Në këtë paraqitje ka marrë pjesë kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, ambasadori i Norvegjisë në Kosovë, Jens Erik Grondahl, zyrtarë të Kuvendit dhe të institucioneve tjera të Kosovës. Me këtë rast, Konjufca ka thënë se ky projekt është shumë i rëndësishëm për Kuvendin e Kosovës, duke shprehur mirënjohje dhe duke vlerësuar lart ndihmën e shtetit të Norvegjisë për Kosovën. Sipas tij, ky projekt në esencë përputhet me rolin e Kuvendit, meqë ky institucion ka një rol qendror në zhvillimet politike prej miratimit të ligjeve e deri te mbikëqyrja e qeverisë. “Kuvendi është shtëpi e qytetarëve, ngaqë të zgjedhurit e tyre janë këtu dhe mendoj se duhet të jetë një shtëpi me dyer të hapura”, ka thënë Konjufca, duke shtuar se ky projekt arrin të përputhet me esencën që e ka - transparencën. “Pra ky projekt ka për qëllim transparencën, sepse qytetarët duhet të kenë qasje të drejtpërdrejtë dhe shumë të lehtë në legjislacion e përfshirje. Në Kuvendin e Kosovës, deri më tani, qytetarëve u jepej një dimension i kufizuar. Qytetarët duan të dinë formën përfundimtare të ligjeve, duan të dinë se cila është ajo formë që ua rregullon jetën atyre dhe çka ata mund të përfitojnë më shumë prej demokracisë dhe legjislacionit”, është shprehur Konjufca, duke shtuar se sa më i vetëdijshëm qytetari dhe sa më afër legjislacionit, niveli i demokracisë është më i madh dhe shoqëria është më e sigurt.

Ndërsa ambasadori i Norvegjisë në Kosovë, Jens Erik Grondahl, ka thënë se ky projekt ka për qëllim që ta rrisë transparencën e punës së Kuvendit të

Republikës së Kosovës dhe jo vetëm të Kuvendit pasi që, siç ka thënë ai, ky projekt do të përfshihet edhe në institucione të tjera të Republikës së Kosovës. “Ky është një format i ri që u mundëson monitorimin e ligjeve të gjithë atyre që janë të interesuar, rëndësinë dhe rolin e tyre në jetën e qytetarëve”, ka thënë ambasadori Grondahl.

Gjatë paraqitjes, menaxheri i projektit, Kare Vollan, ka treguar se si do të funksionojë Shërbimi Informativ Ligjor - Law Data. Ai ka thënë se me anë të këtij shërbimi kushdo që dëshiron mund t’i shohë ndryshimet e mundshme që i bëhen një ligji. Ky projekt, sipas tij, do të realizohet edhe në zyrën e kryeministrit, në Ministrinë e Drejtësisë dhe institucione të tjera shtetërore.

Kurti: Austria dhe Kosova kanë lidhje të forta historike

VJENË, 23 NËNTOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka takuar të martën homologun austriak Alexander Schallenberg, të cilit i ka uruar marrjen e detyrës së re. Kurti ka thënë se Austria dhe Kosova kanë lidhje të forta historike, kulturore dhe politike të cilat do të vazhdohen edhe më tutje. “Sot pata kënaqësinë ta përgëzoj kancelarin Alexander Schallenberg për detyrën e tij të re dhe për të diskutuar me të mënyrat për t’i thelluar marrëdhëniet tona shumë të mira dypalëshe. Austria dhe Kosova kanë lidhje të forta historike, kulturore dhe politike, të cilat qeveria jonë do të vazhdojë t’i mirëmbajë”, ka thënë Kurti në llogarinë e vet në “Twitter”.

Ndërsa kancelari Schallenberg ka bërë me dije se me kryeministrin Kurti ka biseduar edhe për dialogun Kosovë - Serbi. “Takim i mirë me kryeministrin Kurti. Diskutuam për forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve tona të ngushta dypalëshe si dhe për dialogun ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës. Përsërita mbështetjen tonë të plotë për perspektivën evropiane për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor”, ka shkruar Schallenberg në “Twitter”.

KQZ-ja certifikon rezultatet përfundimtare të raundit të dytë të zgjedhjeve

23 NËNTOR (ER) - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka certifikuar të martën rezultatet përfundimtare të raundit të dytë të zgjedhjeve për kryetarë të 18 nga 21 komunat të cilat janë mbajtur më 14 nëntor.

KQZ-ja ka marrë vendim për certifikimin e këtyre rezultateve pas konfirmimeve nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) dhe nga Gjykata Supreme, me përjashtim të rezultateve të kandidatëve për kryetar të komunës së Dragashit, Prizrenit dhe Kllokotit.

Në mbledhje të KQZ-së është bërë me dije se ky komision do të presë që palët t’i shterojnë të gjitha mundësitë brenda afateve të përcaktuara ligjore. Rezultatet e certifikuara u takojnë këtyre 18 komunave: Gjakovë, Drenas, Gjilan, Istog, Kaçanik, Klinë, Fushë Kosovë, Kamenicë, Obiliq, Rahovec, Podujevë, Prishtinë, Shtime, Viti, Vushtrri, Malishevë, Junik dhe Mamushë.

Pas certifikimit të këtyre rezultateve, PZAP-i ka njoftuar se ka refuzuar ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje për rezultatin e zgjedhjeve në Prizren, ku Mytaher Haskuka nga kjo lëvizje ka humbur përballë Shaqir Totajt të PDK-së.



TË MARTËN KANË HUMBUR JETËN 46 PERSONA DHE 7 TË TJERË JANË LËNDUAR NGA NJË AKSIDENT TRAFIKU NË BULLGARI

46 viktima nga aksidenti tragjik në Bullgari, shumica e tyre shqiptarë

- Maqedonia e Veriut shpall tri ditë zie kombëtare për viktimat e aksidentit në Bullgari

Maqedonia e Veriut dhe shqiptarët janë tronditur të martën nga lajmi për vdekjen e 46 personave nga djegia e një autobusi në autostradën Struma të Bullgarisë. Mësohet se viktimat janë shqiptarë, ndërsa në mesin e tyre janë edhe 12 fëmijë. Autoritetet bullgare dhe maqedonase kanë bërë me dije se shkaqet e aksidentit janë duke u hetuar. Dyshimet e para janë se zjarri ka shpërthyer pasi autobusi ka goditur parmakun mbrojtës të autostradës. Nga aksidenti kanë shpëtuar 7 persona, të cilët kanë arritur të largohen nga autobusi dhe gjendja e tyre është stabile. Për këtë aksident tragjik ka pasur reagime edhe nga liderët e Kosovës dhe të Shqipërisë, të cilët janë shprehur të tronditur nga kjo ngjarje

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 23 NËNTOR - Të paktën 46 persona kanë mbetur të vdekur dhe shtatë të tjerë janë lënduar kur një autobus i një agjencie turistike nga Shkupi është kapluar nga flakët në Bullgari.

Mediat nga Maqedonia e Veriut kanë raportuar se viktimat janë shqiptarë, ndërsa në mesin e tyre janë të paktën 12 fëmijë. Zyrtarët e spitalit në Sofje kanë thënë se personat e mbijetuar janë duke u trajtuar dhe gjendja e tyre është jashtë rrezikut për jetë. Autoritetet maqedonase kanë bërë me dije se shumica e viktimave ishin nga Shkupi dhe ishin duke u kthyer nga Stambolli i Turqisë, ku kishin qëndruar në një vizitë treditore.

Aksidenti ka ndodhur në autostradën Struma rreth 45 kilometra në perëndim të Sofjes.

Autobusi i aksidentuar është në pronësi të agjencisë turistike "Besa Trans", e cila, sipas Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve të Maqedonisë së Veriut, ka pasur licencë të rregullt për transport ndërkombëtar, por Inspektorati Shtetëror për Transport ka bërë me dije se ndaj kësaj kompanie gjatë këtij viti janë ngritur katër padi për mosrespektimin të protokolleve kundër Covidit.

Hetimet për shkakun e aksidentit janë duke u zhvilluar. Ministri i Brendshëm i Bullgarisë, Bojko Rashkov, ka deklaruar se autobusi ka shkatërruar parmakun mbrojtës të autostradës, duke shtuar se ka gjasa që zjarri të jetë shkaktuar nga kontakti i autobusit me parmakun mbrojtës.

Ndërsa kryeministri maqedonas Zoran Zaev, së bashku me ministrin e Jashtëm, Bujar Osmani dhe ministrin e Shëndetësisë, Venko Filipçe, kanë shkuar në Bullgari. "Jam në kontakt me kryeministrin Stefan Janev i cili tashmë ka vizituar njerëzit. Pata mundësinë të bisedoja me një nga të mbijetuarit. Ai shpjegoi se ata ishin duke fjetur në autobus kur u dëgjua një shpërthim i fortë. Ata kanë mundur ta thyejnë njërin nga xhamat dhe të shpëtojnë disa persona. Fatkeqësisht, të tjerët nuk ia arritën. Është një tragjedi e tmerrshme. Shumica prej tyre, 12 janë fëmijë nën 18 vjeç, dhe të tjerët janë të rinj rreth 20-30 vjeç. Shumica prej tyre janë shtetas tanë, por ka edhe nga Serbia", ka deklaruar kryeministri Zoran Zaev.

Në anën tjetër, ministri i Shëndetësisë i Maqedonisë së Veriut, Venko Filipçe, pasi ka vizituar të lënduarit të spitalin e Sofjes, ka deklaruar se ata janë në gjendje të qëndrueshme shëndetësore.

Sipas tij, në mesin e atyre që kanë mbijetuar aksidentin e rëndë është edhe një vajzë 16-vjeçare. "Të shtatë të lënduarit që u shtruan në spitalin Pirogov në Sofje, pas aksidentit në Bullgari, janë në gjendje të qëndrueshme shëndetësore dhe askush nuk është në rrezik për jetën. Vetëm një pacient ka frakturë për të cilën duhet të bëhen analiza shtesë dhe të përcaktohet nëse do të duhet operim. Në mesin e të lënduarve është një vajzë 16-vjeçare, ndërsa të tjerët janë të moshës 40-50-vjeçare", ka deklaruar Filipçe.

Kurse ministri i Punëve të Jashtme të Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani, ka thënë se shumica e viktimave janë nga Shkupi, të cilët po ktheheshin nga Turqia ku kishin shkuar për një vizitë treditëshe në Stamboll. "Sipas të dhënave të para që kam, bëhet fjalë për një agjenci turistike nga Shkupi dhe shumica e viktimave janë nga

→

Shkupi. Në mesin e tyre ka më shumë se dhjetë fëmijë, por kishte edhe shumë të rinj të tjerë që kishin shfrytëzuar pushimin e zgjatur, pasi të hënën ishte ditë feste", ka deklaruar Osmani.

Liderët e Ballkanit dhe të BE-së solidarizohen me Maqedoninë e Veriut

Liderët e vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe zyrtarë të lartë të Bashkimit Evropian (BE) kanë shprehur solidaritetin e tyre me Maqedoninë e Veriut pas aksidentit me autobus në Bullgari. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka shprehur gatishmërinë që t'i ndihmojë autoritetet maqedonase pas aksidentit në Bullgari. "Republika e Kosovës bashkëndien me Maqedoninë e Veriut, popullin e saj dhe të gjithë shqiptarët e tronditur nga ky lajm i kobshëm, dhe shpreh gatishmërinë e plotë për ta ofruar ndihmën e saj me çdo kapacitet", ka shkruar Kurti në profilin e vet në "Facebook".

Edhe kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka shprehur ngushëllime për tragjedinë në Bullgari. "S'ka fjalë për tragjedinë e autobusit nga Maqedonia e Veriut në Bullgari, ku kanë humbur jetën thuajse të gjithë udhëtarët… Dhimbje", ka shkruar Rama.

Në mesin e atyre që kanë reaguar pas kësaj ngjarjeje tragjike kanë qenë edhe presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ai i LDK-së, Lumir Abdixhiku, lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ai i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti etj.

Përveç liderëve politikë të Kosovës dhe të Shqipërisë, telegram ngushëllimi autoriteteve maqedonase u kanë dërguar edhe liderët e tjerë të rajonit.

Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, në telegramin e tij të ngushëllimit, ka thënë se nuk ka fjalë për ta përshkruar dhimbjen që ndajnë me qytetarët e Maqedonisë. "Me mosbesim dhe pikëllim mora lajmin e tmerrshëm për vdekjen tragjike të pasagjerëve të autobusit në Bullgari. Nuk ka fjalë për ta përshkruar dhimbjen që ndajmë me qytetarët e vendit tuaj. Serbia është me ju, e gatshme për të ofruar të gjithë ndihmën dhe mbështetjen e nevojshme, sepse nuk jeni vetëm në këtë tragjedi", ka shkruar Vuçiqi.

Edhe presidenti i Malit të Zi, Millo Gjukanoviq, përmes një telegrami ngushëllimi ka thënë se shteti i tij ndan dhimbjen me popullin maqedonas. "Ju lutemi përcillni ngushëllimet më të sinqerta për familjet e viktimave dhe urimet më të mira për pasagjerët e mbijetuar për shërim të shpejtë", është thënë në telegramin e ngushëllimit të presidentit të Malit të Zi.

Edhe presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, ka shprehur ngushëllimet për familjarët e personave që vdiqën në aksidentin tragjik. Ndërsa komisionari i BE-së për fqinjësi dhe zgjerim, Oliver Varhelyi, e ka quajtur tragjik aksidentin me autobus në Bullgari. "Lajme të tmerrshme lidhur me aksidentin tragjik në Bullgari në orët e para të mëngjesit. Mendimet dhe ngushëllimet e mia për familjarët dhe miqtë e atyre që vdiqën dhe për popullin dhe autoritetet e Maqedonisë së Veriut", ka shkruar Varhelyi në "Twitter".

Maqedonia e Veriut shpall tri ditë zie kombëtare

Qeveria e Maqedonisë së Veriut ka shpallur të martën tri ditë zie kombëtare pas aksidentit me autobus në Bullgari që la të vdekur të paktën 46 persona. Në nderim të viktimave, flamujt shtetërorë para ndërtesës së qeverisë janë ulur në gjysmështizë. Zyrtarët qeveritarë kanë bërë me dije se Qeveria e Maqedonisë së Veriut do t'u gjendet pranë familjarëve të viktimave dhe të të lënduarve. Gjithashtu, është bërë me dije se qeveria do të merret me ceremoninë mortore të tyre. Ndërsa kryetari i komunës së Tetovës, Bilall Kasami, ka bërë me dije se për shkak të aksidentit tragjik ka vendosur që t'i pezullojë të gjitha aktivitetet deri më 28 nëntor. "Së pari ndajmë dhembjen dhe u shprehim ngushëllimet tona të sinqerta familjarëve që humbën më të dashurit e tyre në aksidentin e komunikacionit të ndodhur sot në mëngjes në Bullgari, kurse të lënduarve u dëshirojmë shërim të shpejtë. Komuna e Tetovës njofton opinionin e gjerë se për shkak të situatës së rëndë që po mbretëron në Maqedoninë e Veriut, pezullon të gjitha aktivitetet deri ditën e diel (28.11.2021)", ka shkruar Kasami në profilin e vet në "Facebook".

Aksidenti tragjik që ka ndodhur në orët e para të ditës së martë në Bullgari po konsiderohet si aksidenti më i rëndë automobilistik në 10 vjetët e fundit në Evropë.



Rreziku nga minat në Kosovë është ende real

PRISHTINË, 23 NËNTOR - Një ditë pranvere e pasluftës është shndërruar në ditën më tragjike për Elmi Xhemën nga qyteti i Shtimes në Kosovë. Si 12-vjeçar, në maj të vitit 2001, Elmiu ka dalë për të luajtur në oborr të shtëpisë, ku edhe ka shkelur në minë. Për pasojë, ka humbur këmbën dhe dorën e majtë. "Nuk kam ditur asgjë deri kur më kanë dërguar në spital, pastaj e kam marrë vesh se çfarë ka ndodhur me mua", ka rrëfyer Elmiu për "Radion Evropa e Lirë".

Mina në oborrin e shtëpisë së Elmiut ka qenë një ndër mjetet e shumta shpërthyese që janë vendosur nga ushtria serbe nëpër Kosovë gjatë luftës së fundit më 1998/99.

Elmiu, sot 32 vjeç, ka arritur të sigurojë proteza të gjymtyrëve, me të cilat funksionon, por nuk ka arritur ta vazhdojë shkollimin. "Pasi më ka ndodhur kjo, nuk kam pasur vullnet (për shkollë), më ka humbur motivi dhe e kam lënë", ka treguar ai.

Mjetet shpërthyese, të mbetura nën tokë nga koha e luftës, kanë marrë jetën e 117 personave në Kosovë. Sipas të dhënave të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), shumica e civilëve kanë pësuar nga minat shumë shpejt pas luftës. Njësitet ushtarake që kanë funksionuar në Kosovë në 20 vjetët e fundit kanë qenë përgjegjëse për largimin e mjeteve shpërthyese. Të gjitha operacionet janë kryer në bashkëpunim edhe me ekipet e çminimit nga misioni paqeruajtës i NATO-s, KFOR-i dhe organizatat civile për çminim.

Njësiti ushtarak, që quhet Kompania e Çminimit, ka funksionuar që nga viti 2001, fillimisht në kuadër të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK), që kanë dalë nga transformimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Nga viti 2009, përkatësisht pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në shkurt të vitit 2008, TMK-ja është shndërruar në Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK).

Togeri Petrit Loxha nga Kompania e Çminimit ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se menjëherë pas luftës ushtria e atëhershme jugosllave ka dorëzuar hartat e zonave të minuara.

Këto harta kanë treguar për 620 fusha të minuara, 1 300 caqe të bombarduara nga NATO-ja, si dhe 2 500 raportime të mjeteve të rrezikshme. Pra, në total, kanë ekzistuar afro 4 500 zona të rrezikshme në pjesë të ndryshme të Kosovës. "Në 20 vjet punë, deri më sot, kanë mbetur më pak se 70 pika të rrezikshme me interes", ka thënë Loxha. Sipas të dhënave të FSK-së, deri më tani janë pastruar mbi 59 milionë metra katrorë tokë, si dhe janë larguar mbi 23 mijë mina, 21 mijë kasetë-bomba dhe mbi 48 mijë mjete të tjera shpërthyese.

Ndonëse, sipas FSK-së, është bërë punë e madhe për largimin e të gjitha mjeteve shpërthyese në territorin e Kosovës, ka ende pika që mund të jenë me rrezik. "Zonat më të prekura me mina kanë qenë pikat kufitare me Shqipërinë dhe Maqedoninë [e Veriut], shkaku i armiqësive të kohës së komunizmit dhe luftërave të viteve '99-2001. Këto mbeten zonat më të prekura edhe sot", ka thënë Loxha.

Aksionet e çminimit deri më tani janë përqendruar në zonat e banuara por, sipas FSK-së, ato do të fokusohen tani në zonat kufitare. Gjatë këtij viti FSK-ja ka kryer disa operacione të pastrimit të fushave të kontaminuara me mjete të pashpërthyera në rajonet e Hanit të Elezit, Gjakovës dhe Ferizajt. Sipas FSK-së, deri më tash në vitin 2021 janë gjetur 400 mjete shpërthyese dhe 951 fishekë. Mjetet e pashpërthyera pritet të jenë rrezik potencial edhe për një kohë të gjatë, thotë Avni Islami, profesor i shkencave të sigurisë. Sipas tij, largimi i të gjitha mjeteve të tilla në Kosovë merr më shumë kohë. "Sot e kësaj dite kemi mjete të pashpërthyera edhe nga Lufta e Dytë Botërore, e lëre më në këtë kohë, kur forcat serbe kanë minuar sipërfaqe të mëdha...", ka thënë Islami për "Radion Evropa e Lirë".

Ai ka theksuar se qytetarët duhet të informohen vazhdimisht për rrezikun potencial, qoftë përmes televizionit, apo mediave online. "E rëndësishme është që opinioni publik të informohet mbi rrezikun që shkakton një mjet i pashpërthyer. Të bëhet vetëdijesimi i qytetarëve që, në rast se hasin në mjet të pashpërthyer, t'i lajmërojnë organet kompetente", ka thënë Islami.

Raporti 24-orësh i MSh-së: 15 raste të reja me Covid dhe 2 449 të vaksinuar

PRISHTINË, 23 NËNTOR (ER) - Ministria e Shëndetësisë (MSh) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit në Kosovë janë paraqitur 15 raste të reja me Covid dhe janë shëruar tetë persona. Sipas kësaj ministrie, në 24 orët e fundit janë dhënë 2 499 doza të vaksinës kundër Covidit. "Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 607 518 doza të vaksinës. Deri më sot 757 103 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Nga 1 440 testime, 15 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes. Sot janë shëruar 8 qytetarë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve është 157 719. Në total numri i rasteve aktive është 330", ka njoftuar MSh-ja.



IKD-ja: Mungesa e llogaridhënies së gjyqtarëve dhe prokurorëve, pengesë për avancimin e sistemit të drejtësisë

PRISHTINË, 23 NËNTOR - Mungesa e llogaridhënies së gjyqtarëve dhe prokurorëve është pengesa kryesore e avancimit të sistemit të drejtësisë në Kosovë. Një vlerësim i tillë ka dalë nga raporti "Llogaridhënia pa progres - analizë e (mos)zbatimit të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve" i cili është publikuar të martën nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD).

Gëzim Shala nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), i cili e ka paraqitur këtë raport, ka thënë se ky dokument është rezultat i monitorimit të drejtpërdrejtë që i është bërë zbatimit në praktikë të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Ai ka treguar se nga 276 ankesa disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve, kryetarët e gjykatave dhe kryeprokurorët gjatë viti 2020 dhe gjysmës së parë të vitit 2021 kanë hedhur poshtë gjithsej 233 ankesa disiplinore. "Ajo që vjen në pah nga monitorimi i IKD-së është mungesa e vullnetit për ngritjen e llogaridhënies së gjyqtarëve dhe prokurorëve, e cila mungesë e vullnetit ka bërë që as sistemi i ri i llogaridhënies së gjyqtarëve dhe prokurorëve mos të japë efektet e dëshiruara. Një nga gjetjet e këtij raporti është trajtimi i ankesave disiplinore nga autoritetet kompetente, përkatësisht nga kryetarët e gjykatave dhe kryeprokurorët. Mbi 80 për qind të ankesave disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve janë hedhur nga autoritetet kompetente, përkatësisht nga kryetarët e gjykatave dhe kryeprokurorët. Ajo çfarë bie në sy në këtë rast është mungesa e arsyetimeve meritore ndaj aktvendimeve me të cilat edhe hedhen ankesat disiplinore. Në anën tjetër, ka pak raste të cilat kanë shkuar në Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGjK) apo në Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK) për hetim të mëtutjeshëm të rasteve disiplinore. KGjK-ja dhe KPK-ja në shumicën dërrmuese të rasteve i kanë liruar gjyqtarët dhe prokurorët nga përgjegjësia disiplinore", ka deklaruar Shala.

Sipas tij, IKD-ja ka gjetur se masa më e rëndë e shqiptuar nga KGjK-ja dhe nga KPK-ja në rastet disiplinore ka qenë zvogëlimi i pagës.

Shala ka pasur kritika edhe sa i përket Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP), siç ka thënë ai, për mosveprim në rastet e hedhjeve të ankesave disiplinore nga ana e autoriteteve kompetente. "Aspekt tjetër jashtëzakonisht problematik në këtë drejtim është qasja që Avokati i Popullit ka pasur në sistemin e llogaridhënies së gjyqtarëve dhe prokurorëve. IAP-i vazhdimisht ka thënë se të njëjtët nuk kanë kompetencë për t'i trajtuar ankesat ndaj rasteve disiplinore, përjashtimisht nëse vetë autoritetet kompetente nuk vendosin në këto raste. IKD-ja ka avokuar vazhdimisht se, bazuar në Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, Avokati i Popullit ka të drejtë që nëse një rast është hedhur dhe Avokati i Popullit gjen arsye se nuk është dashur të hedhet ta procedojë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës përkatësisht në Këshillin Prokurorial, mirëpo qasja e tyre ka qenë ndryshe dhe për këtë arsye IKD-ja në një rast e ka iniciuar rastin në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, e cila gjykatë ka konfirmuar qëndrimet e IKD-së mbi rolin e Avokatit të Popullit që ka në procesin e llogaridhënies së prokurorëve dhe gjyqtarëve", ka deklaruar ai.

Shala ka bërë me dije se raporti ka kritika edhe për Ministrinë e Drejtësisë. Sipas tij, kjo ministri ka injoruar nevojat reale për plotësim-ndryshimin e Ligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe se i ka injoruar komentet e shoqërisë civile.

Ndërsa Anesa Hoxha nga IKD-ja ka paraqitur rekomandimet që dalin nga ky raport. Ajo ka vlerësuar se rekomandojnë që autoritetet kompetente mos të kalojnë nivelin e kompetencës së tyre për t'i vlerësuar meritat e ankesës disiplinore. "IKD-ja ka rekomanduar që autoritetet kompetente mos të kalojnë nivelin e kompetencës së tyre për t'i vlerësuar meritat e ankesës disiplinore, por të kufizohen në vlerësimin nëse një ankesë disiplinore përbën çështje disiplinore. Këto autoritete të japin arsyetime meritore në vendimet e tyre lidhur me ankesat disiplinore, si dhe të vendosin brenda afateve ligjore. Autoritetet kompetente që nuk vendosin brenda afateve ligjore të mos amnistohen nga KPK-ja. Me rastin e shqyrtimit të gjendjes faktike të një rasti disiplinor, KGjK-ja ta trajtojë gjendjen faktike sipas gjithë dokumentacionit dhe mos të fokusohet vetëm në dokumentet apo provat e tjera të cilat shkojnë në favor të vetëm njërës palë. IKD-ja rekomandon që KGjK-ja përmes lirimit të gjyqtarëve nga përgjegjësia disiplinore mos të lejojë normalizimin e praktikave të cilat cenojnë dinjitetin dhe profesionalizimin e sistemit gjyqësor", ka deklaruar Hoxha.

Abbott: Raportet me Kosovën janë të forta dhe nuk do të ndryshojnë

PRISHTINË, 23 NËNTOR - Ambasadori i Britanisë së Madhe në Prishtinë, Nicholas Abbott, ka thënë se marrëdhëniet me Kosovën janë të shkëlqyera dhe me themele të forta. Pas takimit me anëtarët e Komisionit për Punë të Jashtme, ai ka thënë se këto raporte nuk do të ndryshojnë. Sipas tij, marrëdhëniet bilaterale në mes të dy vendeve duhet të thellohen edhe më tutje. "Ne kemi pasur një rast të mirë për të biseduar jo vetëm për marrëdhëniet dypalëshe, por edhe të flasim më gjerësisht për çështjet në rajon dhe, pa dyshim, për të ardhmen e Kosovës brenda Evropës. Kemi një marrëdhënie të shkëlqyeshme në mes të Britanisë së Madhe dhe Kosovës. Ka themele të forta, që nuk ndryshojnë. Derisa ecim përpara duke dalë nga kjo pandemi, mendoj se ka mundësi për të bërë më shumë dhe për të punuar në fusha të ndryshme. Kështu që unë jam mirënjohës për mundësinë sot, duke qenë në gjendje të flas për këtë, me anëtarët dhe mezi pres të punoj me ta në të ardhmen për të zhvilluar këto ide, në mënyrë që edhe marrëdhëniet të përmirësohen muaj pas muaj", ka thënë ambasadori Abbott.

Ndërsa kryetari i Komisionit për Punë të Jashtme, Haki Abazi, ka thënë se takimin me ambasadorin britanik ka qenë mjaft produktiv. "Ishte një diskutim jashtëzakonisht i pasur për çështje të marrëdhënieve bilaterale. Me kujdes dëgjuam ambasadorin për pikëpamjet e tij dhe të Britanisë së Madhe për zhvillimet në rajon. Biseduam për bashkëpunimin rajonal, çështjen e integrimit të Kosovës në BE, liberalizimin e vizave si dhe pjesët specifike të bashkëpunimit bilateral ndërmjet Kosovës dhe të Britanisë së Madhe. Normalisht, raportet janë të ndërtuara me një themel të fuqishëm të ndihmës dhe përkrahjes që nga viti 1999 që ka bërë Britania në Kosovë", ka deklaruar Abazi.

Komisioni për Punë të Jashtme vazhdimisht është duke mbajtur takime me përfaqësues diplomatikë të aleatëve ndërkombëtarë të Kosovës. Javën e kaluar ka mbajtur takim me ambasadorin e Gjermanisë në Kosovë.

KOSTT-i ndërpret pagesën e rrymës për katër komunat serbe

Prishtinë, 23 nëntor - Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës (KOSTT) ka ndërprerë mbulimin e shpenzimeve të energjisë elektrike në katër komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës.

Lajmin e ka bërë me dije kryesuesi i bordit të KOSTT-it, Jeton Mehmeti, gjatë raportimit në Komisionin për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti. Ai ka thënë se gjatë këtij muaji kanë ndërprerë ndarjen e mjeteve për këto komuna për shkak se ka përfunduar marrëveshja në mes të KOSTT-it dhe Qeverisë së Kosovës.

Marrëveshja kishte paraparë ta lirojë Qeverinë e Kosovës nga pagesa e 11 milionë eurove për pagesën e rrymës të katër komunave veriore.

Më tutje, Mehmeti ka thënë se nga viti 2017 për pagesën e rrymës në katër komunat veriore shuma totale është 27 milionë e 806 mijë euro ku, sipas tij, 10 milionë euro janë nga Qeveria e Kosovës, ndërsa mbi 17 milionë janë paguar nga KOSST-i.

Projektligji për Inspektimet përplas pozitën me opozitën

Prishtinë, 23 nëntor - Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Inspektimet ka qenë temë diskutimi në Komisionin për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti. Opozita ka kërkuar që të tërhiqet ky projektligj pasi, sipas saj, nuk do të funksionojë në tërësi. Ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, ka thënë se Projektligji për Inspektimet duhet të procedohet sa më parë.

"Parimisht dua të potencoj që ky projektligj të shkojë sa më parë për procedim për shkak të inspektimit të tregut dhe duke pasur parasysh rreziqet në treg nga produktet e huaja. Unë pres edhe rekomandime nga anëtarët e këtij komisioni që të japin sugjerimet e juaja", ka thënë Hajdari.

Ndërsa anëtari i këtij komisioni, deputeti Pal Lekaj, ka thënë se zyra e kryeministrit po tenton t'i kontrollojë edhe inspektimet. "Dua ta di sa i përket këtij ligji se pse duhet të konstatohet inspektorati me një agjenci? Cilat kanë qenë mangësitë e funksionimit të inspektoratit në këtë drejtim dhe pse duhet ta marrë këtë të drejtë zyra e kryeministrit? A është politike që çdo gjë ta kontrollojë kryeministri apo pse? Për mua është e papranueshme që i tërë inspektorati të jetë në zyrën e kryeministrit, pra kështu e shoh si rrezik", ka thënë Lekaj.

Në përkrahje të këtij projektligji ka dalë deputetja e Vetëvendosjes, Mimoza Kusari-Lila. Madje ajo ka thënë se me këtë projektligj është pajtuar edhe Banka Botërore, e cila, sipas saj, ka premtuar përkrahje në këtë drejtim. Pas Kusari-Lilës, fjalën e ka marrë ministrja Hajdari, e cila ka thënë se ky projektligj ka qenë duke pritur në ministrin që drejton dhe se nuk është iniciuar nga kjo qeveri.

"Është shumë e nevojshme që t'i koordinojmë inspektorët sepse nuk mund të kryejmë punë me inspektorët e tregut nëse nuk i kemi edhe inspektorët e ushqimit dhe veterinës. Nuk është se po dëshirojmë që ta kemi në dorë, por që është projektligj që kërkon reformë në fushat inspektuese", ka thënë Hajdari.

Në anën tjetër, kryetari i këtij Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti Komisioni, Ferat Shala, ka pyetur për koston e këtij projektligj. "Nuk jam ithtar i procedimeve të projektligjeve me procedurë të shpejtë. Nëse preken 30 trupa, mundësia e nxjerrjes së një ligji të zbatueshëm do të jetë shumë e vogël. Mandej nuk u tregua kostoja e këtij projektligji. Sa është kostoja e këtij projektligji?", ka pyetur Shala, i cili ka marrë këtë përgjigje nga ministrja Hajdari.

"Kostoja e këtij projektligji është 1 milion euro e që është ndarë nga zyra e kryeministrit, ndërsa platforma e funksionimit do të kushtojë 500 mijë euro", ka thënë ajo.

Më tutje, Abelard Tahiri nga PDK-ja ka kërkuar që ky projektligj të tërhiqet pasi, sipas tij, mund të jetë kundërkushtetues. "Pra është mirë që ta tërheqin, të dihen qartë kompetencat e këtij komisioni sepse besoj se mund të ndeshet me ligj, madje edhe me Kushtetutë", ka thënë Tahiri. Pas diskutimeve, Projektligji për Inspektimet nuk i ka marrë votat e mjaftueshme për t'u proceduar më tutje.

Protestojnë punëtorët e "Ferronikel"-it, kërkojnë të rikthehen në vendin e punës

Prishtinë, 23 nëntor (ER) - Punëtorët e kompanisë "NewCo Ferronikeli", nën organizimin e Sindikatës së Pavarur të Ferronikelit, kanë protestuar të martën para Qeverisë së Kosovës. "Stop diskriminimit të punëtorëve të Ferronikelit!", "Nuk duam të jemi në rrugë, por në fabrikë", "Duam trajtim njerëzor të punëtorit", "Qeveri, reflekto!", "Qeveri, na trajto si aset me vlerë", kanë qenë disa nga pankartat që mbanin në duar punëtorët e "Ferronikel"-it. Ata kanë protestuar për herë të dytë dhe kanë kërkuar kthimin e tyre në vendet e punës, pasi ata kanë mbetur pa punë që prej 8 tetorit kur edhe është ndalur prodhimi në këtë fabrikë. Vlen të përmendet se puna në "Ferronikel" është ndalur për shkak të krizës energjetike.

A do të rikthehet ekonomia botërore në normalitet në vitin 2022?

Nga Henry CURR
“The Economist”

Edhe sa do të zgjasin forcat stagflacioniste që po veprojnë aktualisht mbi ekonominë botërore? Gjatë gjithë vitit 2021, bankat qendrore dhe shumica e ekonomistëve kanë thënë se faktorët që shkaktojnë rritjen e inflacionit dhe ngadalësimin e rritjes ekonomike, do të jenë të përkohshëm.

Se kriza e zinxhirit të furnizimeve do të zbehej, se çmimi i energjisë do të ulej dhe se punonjësit në vendet e zhvilluara që kanë mbetur jashtë fuqisë punëtore – për arsye që askush nuk i kupton plotësisht – do të riktheheshin në punë.

E megjithatë, ndërsa viti 2021 i afrohet mbylljes, tregjet financiare, publiku, madje edhe vetë bankierët qendrorë kanë filluar që ta humbasin besimin. Dilema me të cilën përballen politikë–bërësit është e fortë. Përgjigja që japin tekstet shkollore ndaj inflacionit të shkaktuar nga ndërprerjet e furnizimeve, është shpërfillja dhe duke e lënë që të largohet vetë.

E pse të dëmtohen ekonomitë me normat më të larta të interesit, të cilat tek e fundit nuk do të zhbllokojnë situatën në porte, nuk do të krijojnë furnizime të reja me gaz natyror, dhe as nuk do t’i japin fund pandemisë së Covid-19?

Në vitin 2011, inflacioni në Britani u rrit në 5.2 për qind si pasojë i rritjes së çmimeve të mallrave, por Banka e Anglisë i mbajti të ulëta normat e interesit. Në eurozonë, Banka Qendrore Evropiane i rriti normat, duke ndihmuar në daljen e ekonomisë së saj nga recesioni, dhe shumë shpejt u përball me një inflacion shumë nën objektivin e saj.

Ashtu si atëherë, inflacioni në vitin 2022, i nxitur nga çmimet e larta të energjisë ka të ngjarë që të bjerë. (Inflacioni është shkalla e ndryshimit të çmimeve, gjë që do të thotë që edhe nëse çmimet nuk kthehen në nivelet e mëparshme, mjafton që të mos rriten aq shpejt).

Por krahasimi me fillimin e viteve 2010 është i pasaktë. Vështirësitë që ka hasur tregtia globale këtë vit, nuk janë shkaktuar vetëm nga ndërprerjet e zinxhirëve të furnizimit, siç janë për shembull vatrat e reja tëCovid-19 që po detyrojnë mbylljen e shumë fabrikave në Vietnam.

Ndëkohë stimulimi masiv fiskal dhe monetar, i kombinuar me distancimin social, i nxiti konsumatorët të konsumonin mallra nga më të ndryshmet, për të cilat as nuk kishin nevojë.

Në verën e këtij viti, shpenzimet e amerikanëve për produkte fizike ishin 7 për qind mbi prirjen mesatare para pandemisë. Edhe në vende të tjera, ka mungesë të mallrave në krahasim me kërkesën jashtëzakonisht të lartë për to.

Që ekonomia botërore të rikthehet në një lloj normaliteti, duhet që konsumatorët të shpenzojnë më shumë nga paratë e tyre të bollshme për shërbime, si ushqimi në restorant dhe udhëtimet. Mjerisht, ekonomitë janë të dëmtuara nga mungesa e punëtorëve të nevojshëm në këto industri, gjë që pengon lulëzimin e tyre.

Pagat në sektorin e argëtimit dhe të turizmit janë në rritje. Shumë ekonomistë shpresonin që punonjësit do të riktheheshin në masë, pasi përfundoi mbështetja emergjente për tregjet e punës, siç ishin skemat e ndihmës sociale për ata që u pushuan nga puna.

Por deri më tani, çuditërisht ka pak shenja që kjo gjë do të ndodhë. Që inflacioni të jetë i përkohshëm, duhet që të ndalet si rritja e pagave po ashtu edhe rritja e çmimeve. Alternativat janë një rritje e pamundur e produktivitetit, ose marzhe më të ulëta të fitimit, të cilat për biznese të tilla si restorantet janë tashmë të ulëta.

Disa ekspertë të politikave monetare, kanë filluar që të kenë frikë se mos ndodh e kundërta:rritja e pagave vazhdon, ndërsa punonjësit presin një inflacion më të lartë. Bota e pasur nuk ka parë një spirale të rritjes së madhe të pagave që prej vitit 1970, dhe ekspertët argumentojnë se në ekonomitë pa një rol të rëndësishëm të sindikatave, punëtorët nuk kanë gjasa që të negociojnë me punëdhënësit për paga më të larta.

Por nëse pritshmëria në rritje mbi inflacionin vërtetohet të jetë një profeci vetëpërmbushëse, atëherë puna e bankave qendrore do të bëhet papritmas shumë më e vështirë. Ata nuk do të ishin më në gjendje që ta mbanin inflacionin sipas objektivave të tyre, pa sakrifikuar vendet e punës.

Tregjet në zhvillim janë mësuar me këtë kalim të dhimbshëm midis rritjes ekonomike dhe inflacionit, por për dekada ajo nuk e ka dëmtuar shumë botën e pasur. Ndër vendet e mëdha të pasura, më pranë politikave monetare shtërnguese është Banka e Anglisë, e cila synon të ruajë besueshmërinë e objektivit të saj mbi inflacionin, në vend që kjo të garantohet nga kushtet ekonomike themelore.

Është e lehtë të imagjinohet që politikë–bërësit të rrisin normat e interesit, dhe më pas të pendohen për këtë veprim. Ndonëse inflacioni do të mbetet i lartë në muajt e parë të vitit 2022, bankierët qendrorë zakonisht mendojnë se duhet të paktën një vit e gjysmë që normat më të larta të interesit të japin efektin e tyre të plotë në ekonomi.

Forcat që më parë mbanin në nivele të ulëta normat globale dhe inflacionin – ndryshimi demografik, pabarazia dhe kërkesa e shfrenuar globale për asete të sigurta – mund të kenë rifituar fuqinë e tyre deri atëherë. Forcimi i menjëhershëm i politikave fiskale në shumë vende, do të ndihmojë në qetësimin e ekonomive:Britania ka njoftuar rritje të mëdha të taksave, ndërsa presidenti amerikan Joe Biden po përpiqet të miratojë në Kongres disa programe të mëdha shpenzimesh.

Dhe rritja më e ngadaltë ekonomike në Kinë, vend që po përballet me një krizë në tregun e pasurive të paluajtshme, mund të përhapet globalisht. Mbi të gjitha, pandemia nuk ka mbaruar ende. Përhapja e mëtejshme e virusit mund t’i dëmtojë sërish ekonomitë nëse zbehet imuniteti, dhe nëse vaksinat nuk do të jenë efektive për variantet e reja të virusit që mund të shpërfaqen.

Por me zinxhirët e furnizimit në limitet e tyre, bota nuk mund të përsërisë iluzionin e ruajtjes së rritjes ekonomike në nivelet e dëshiruara, përmes përdorimit të stimujve fiskalë, që i zhvendos shpenzimet e konsumatorit drejt mallrave fizikë.

Përkundrazi, bankat qendrore do të duhet të frenojnë rritjen e shpenzimeve përmes miratimit të normave më të larta të interesit,për të shmangur inflacionin e tepruar, për aq kohë sa oferta të përshtatet me modelet e shpenzimeve dhe tregun e punës, të cilat aktualisht janë shumë të ndryshme nga situata që mbizotëronte në vitet 2010. Nëse normaliteti nuk kthehet në vitin 2022, alternativa është një rregullim i dhimbshëm ekonomik.

Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Nuhiu dhe Haxhimusa kërkojnë fitore në derbin ndaj Gjilanit

Sot (e mërkurë) zhvillohet derbi në mes të Gjilanit dhe Dritës në kuadër të javës së 15-të. Trajneri Ardian Nuhiu dhe futbollisti Betim Haxhimusa kanë shprehur optimizëm se skuadra e tyre mund të shënojë fitore. Krahas kësaj ndeshjeje, sot do të zhvillohet edhe përballja në mes të Drenicës dhe Llapit si dhe ajo në mes të Ballkanit dhe Malishevës

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 23 NËNTOR - Trajneri i Dritës, Ardian Nuhiu dhe futbollisti Betim Haxhimusa, kanë shprehur optimizëm për ndeshjen derbi ndaj Gjilanit, e cila zhvillohet të mërkurën në kuadër të javës së 15-të. Trajneri Nuhiu ka thënë se është kënaqësi të jesh pjesë e këtij derbi të madh në futbollin e Kosovës, por edhe një përgjithësi e madhe. "Është kënaqësi të jesh pjesë e kësaj ndeshjeje, por edhe përgjithësi se e dimë sa e veçantë është kjo ndeshje për tifozët. Gjithashtu, edhe klasifikimi i të dyja skuadrave flet shumë. E kemi studiuar kundërshtarin, por edhe e njohim mirë. Gjilani po përformon mirë si grup, por ka edhe individë që mund të vendosin për ndeshjen. Kemi punuar që t'i mos i përsëritim ndeshjet e para dhe më gëzon fakti se futbollistët, në përjashtim të Jasharit, janë të gatshëm për këtë ndeshje. Shoh te skuadra motiv të veçantë pasi edhe ndeshja është e tillë. Duhet t'i shfrytëzojmë pikat e dobëta të kundërshtarit që do të paraqiten gjatë ndeshjes", ka thënë Nuhiu. Ndërsa sulmuesi Betim Haxhimusa ka konfirmuar se motivi është i madh në klubin e Dritës dhe se synim i vetëm në këtë ndeshje është fitorja. "Kënaqësi ta përjetojmë këtë derbi. Kësaj radhe nuk është vetëm derbi i qytetit, por edhe derbi për kreun e tabelës. Do ta japim maksimumin që të fitojmë këtë ndeshje dhe të dalim në

vendin e parë e atë pozitë ta mbajmë deri në fund të kampionatit", ka thënë Haxhimusa.

Prishtina mposhti Feronikelin, Dukagjini ndahet baras me Ulpianën

Dy ndeshje të javës së 15-të në Superligën e Kosovës në futboll janë zhvilluar të martën. Prishtina në stadiumin "Fadil Vokrri" e mposhti Feronikelin (2-0), kurse Dukagjini ndau pikët me Ulpianën. Kryeqytetasit shënuan fitoren e parë nën drejtimin e trajnerit të ri, Abdulah Ibrakoviq. Prishtina dominoi në pjesën e parë, por nuk arriti ta gjejë rrugën e golit. Ndërsa golin e parë vendasit e realizuan në minutën e 60, kur Leonit Abazi, në tentim për ta krosuar, shënon gol të bukur për rezultatin 1-0. Tre minuta para fundit të ndeshjes, Bleart Tolaj realizoi për 2-0. Pas tri pikëve të reja, Prishtina zë vendin e pestë me 21 pikë, kurse Feronikeli është i fundit me vetëm 10 pikë. "Ishte një fitore e vështirë, ashtu siç e kemi parashikuar, pasi Feronikeli u mbyll para portës mirë dhe na detyroi që gjatë tërë pjesës së parë ta kërkojmë golin. Arritëm të shënojmë dy gola në pjesën e dytë dhe ta sigurojmë fitoren që është e rëndësishme. Po punojmë që ekipi të përmirësohet edhe më shumë dhe besoj që do të jemi më të mirë", ka thënë Abdullah Ibrakoviq, trajner i Prishtinës.

Në ndeshjen tjetër, Dukagjini shpëtoi nga humbja në përballje me Ulpianën, pasi pak para fundit e barazoi rezultatin 1-1. Në minutën e 55-të, mysafirët kaluan në epërsi me golin e Ermir Rezi, kurse nëntë minuta para fundit Altin Merlaku e barazoi rezultatin në 1-1. Ulpiana ka grumbulluar 17 pikë dhe është në vendin e shtatë, kurse Dukagjini gjendet në vendin e tetë me 16 pikë.

BKT Superliga Java e 15-të

Prishtina - Feronikeli 2-0
Dukagjini - Ulpiana 1-1

Të mërkurën takohen:

13:00 Gjilani - Drita
13:00 Drenica - Llapi
13:00 Ballkani - Malisheva

Berisha: Japim maksimumin për rezultat pozitiv

PRISHTINË, 23 NËNTOR - Kosova do të ketë dy ndeshje shumë të rëndësishme në parakualifikimet për FIBA Eurobasket 2025. "Dardanët" më 25 nëntor përballen me Norvegjinë në udhëtim, ndërsa më 28 nëntor e presin Danimarkën. Të dyja ndeshjet zhvillohen nga ora 19:00. Vendi i parë kualifikohet tutje si dhe vendi i dytë më i mirë nga tri grupet parakualifikuese. Kapiteni i "dardanëve", Dardan Berisha, është shprehur se do ta japin maksimumin. "E dimë rëndësinë e ndeshjeve dhe sigurisht se do ta japim maksimumin në këto dy përballje të rëndësishme për ne. Fillimisht do të përballemi me Norvegjinë, kurse më pas takohemi me Danimarkën në Prishtinë, ku shpresojmë përkrahje nga publiku, që na ka munguar shumë, edhe pse do të jetë në numër më të vogël", është shprehur Berisha për faqen zyrtare të FBK-së. Ai ka motivuar skuadrën para këtyre dy ndeshjeve. "Besoj se të gjithë do të japin më të mirën në këtë ndeshje. Për ne është nder të luash për vendin tënd dhe shpresojmë në rezultate pozitive në këto dy përballje", ka shtuar Berisha. Basketbollistët e Kosovës në fundjavë kanë stërvitur në Prishtinë dhe të hënën udhëtuan drejt Norvegjisë, aty ku presin edhe përkrahjen nga tifozët shqiptarë, ashtu siç e kanë përkrahur në çdo ndeshje si mysafirë.

Sot fillon Liga Unike te femrat

PRISHTINË, 23 NËNTOR - Historike për basketbollin e femrave. Në këtë mesjavë do të fillojë Liga Unike në konkurrencën e femrave. Do të garojnë tri skuadra nga Kosova dhe tri nga Shqipëria. Kjo është hera e parë që organizohet një ligë në mes të skuadrave më të mira nga të dyja shtetet në konkurrencën e femrave. Te femrat do të zhvillohen dhjetë xhiro (vajtje-ardhje), më pas faza e "play-off"-it. Fillimisht ishte mbajtur Superkupa Mbarëkombëtare në Vlorë, ku kishte fituar Penza e Pejës, kampione aktuale e Kosovës. Në xhiron e parë do të përballen dy skuadrat kryeqytetase, Tirana dhe Prishtina, ku pritet një sfidë interesante, me të dy skuadrat që synojnë fitore. Të mërkurën në mbrëmje është një përballje shumë interesante në mes të Bashkimit dhe Partizanit, dy skuadra që kanë ambicie të mëdha në këtë edicion. Të enjten përballen kampioni i Shqipërisë, Flamurtari nga Vlora dhe kampionia e Kosovës, Penza e Pejës. Skuadra nga Vlora ka fituar Kupën e Federatës së Shqipërisë, ndërsa vashat pejane kanë fituar Superkupën e Kosovës dhe edicionin historik të Superkupës Mbarëkombëtare. Të dyja këto skuadra u përballën edhe në Vlorë gjatë Superkupës Mbarëkombëtare, ku fituan vashat nga Peja me rezultat 70:79 për të depërtuar në finale, ku triumfuan ndaj Prishtinës.

LIGA UNIKE (FEMRAT) - JAVA 1

Të mërkurë takohen:
17:00 Tirana - Prishtina
19:00 Bashkimi - Partizani

Të enjten takohen:
17:00 Flamurtari - Penza

Stroneri: Doja të isha shok skuadre me Rossin, por dikush ishte kundër

CANBERRA, 23 NËNTOR - Ish-piloti australian Casey Stroner, dy herë kampion bote në MotoGP, ka rrëfyer në një intervistë për DAZN se dy herë ka qenë pranë kalimit te Yamaha, ku asokohe garonte Valentino Rossi. Ata ishin rivalë në pistë, por Stoner rrëfen se ka dashur shumë të ishte shok skuadre me pilotin italian, që u tërhoq nga sporti këtë vit. "Kam kërkuar të isha shok skuadre me Rossin në dy raste. Nuk e di përse nuk u realizua ky kalim, por dikush te Yamaha nuk lejoi që kjo gjë të ndodhte. Me shumë gjasa ai të cilit i referohem e kupton. Do të më kishte pëlqyer shumë të garoja me Rossin në një ekip, ta kisha mundësinë të mësoja më shumë prej tij", ka thënë Stoner. Australiani ka fituar dy tituj kampionë në MotoGP (2007 dhe 2011), ndërkohë që nuk bëri me dije se cili ishte ai person që e pengoi të kalonte te Yamaha. Dëshira e tij për të garuar në një ekip me Rossin nuk u realizua asnjëherë edhe pse ishin rivalë të denjë në pistë kudo që garonin.

Messi: Barça do rritet me Xavin, dua të rikthehem një ditë

PARIS, 23 NËNTOR - Ish-lojtari i Barcelonës dhe tashmë një futbollist i PSG-së, Lionel Messi, ishte një nga largimet më të bujshme në merkaton e verës teksa vendosi të largohej nga blaugranat dhe të transferohej në Paris. Sulmuesi argjentinas në një intervistë të dhënë për "Marca" shprehet se Barça me trajner Xavi Hernandezin do të rritet sepse ky i fundit është një person që njeh çdo hallkë të klubit. Në këtë intervistë "Pleshti" nuk përjashtoi edhe mundësinë e rikthimit të tij në "Camp Nou", nëse do të ishte në favor të të dyja palëve. "Me Xavin, Barcelona do të rritet, është trajner që di shumë dhe e njeh mirë shtëpinë. Gjithmonë kam thënë se do të doja rikthimin te Barcelona, nëse do ta ndihmoja klubin do të doja të rikthehesha", ka thënë Messi. Argjentinasi nuk la pa përmendur edhe Ligën e Kampionëve ku PSG është favoriti kryesor për ta fituar këtë vit. "Të gjithë thonë se ne jemi favoritët e mëdhenj dhe nuk do ta mohoj se jemi një ndër kandidatët, por duhen ende gjëra që të bëhemi skuadër e fortë", ka përfunduar 34-vjeçari.

Brooklyni merr kreun në Lindje

REZULTATET

Cleveland - Brooklyn	112-117
Washington - Charlotte	103-109
Atlanta - Oklahoma	113-101
Boston - Houston	108-90
Chicago - Indiana	77-109
Milwaukee - Orlando	123-92
New Orleans - Minnesota	96-110
San Antonio - Phoenix	111-115
Utah Jazz - Memphis	118-119
Sacramento - Philadelphia	94-102

Brooklyn, 23 nëntor - Brooklyn ngjitet në krye të renditjes në Konferencën e Lindjes pas fitores me rezultat 117-112 në fushën e Clevelandit. Ky është suksesi i 13-të në kampionat për Netsin, ku për miqtë shkëlqeu Duranti me 27 pikë. Zbret në vendin e katërt në Lindje ekipi i Washingtonit, që u mund me rezultat 109-103 nga Charlotte (Rozier 32 pikë). Nuk zhgënjen skuadra kampione e Milwaukees, që mundi me rezultat 123-92 Orlandon, takim ku dallimin për vendasit e bëri kolektiviteti (7 lojtarë realizuan mbi 10 pikë). Humbet ekipi i Utah Jazzit, që zbret në vendin e tretë në Perëndim, duke u mundur në sekondat e fundit 119-118 nga Memphisi (Morant 32 pikë).

SHKURT

U mbajt kursi i licencës C për portierë

Federata e Futbollit e Kosovës po vazhdon procesin e edukimit të kuadrove të reja të futbollit. Gjatë kësaj jave është organizuar kursi i dytë për licencën C për portierë, ku kanë qenë të përfshirë 22 pjesëmarrës, të cilët më herët e kanë përfunduar kursin e licencës D. Para ndjekësve të këtij kursi ka ligjëruar instruktori ndërkombëtar David Wetzel nga SC Freiburg, teksa atij i kanë asistuar edhe instruktorët vendorë, Artan Sadriu dhe Valmir Bytyqi. Pjesa e teorisë është mbajtur online nëpërmjet platformës "Edubreak", derisa pjesa praktike është mbajtur në Kompleksin Nacional Edukativ të FFK-së në Hajvali.

Të shtunën mbahet turneu 3x3 nga Federata e Punëtorëve Sportivë

Federata e Punëtorëve Sportivë të shtunën do të organizojë turneun në 3x3 për nder të 28 Nëntorit, Festës së Flamurit. Turneu do të mbahet të shtunën me fillim nga ora 10:00 deri në orën 15:00 në Qendrën Social-Edukative "Don Bokso". Skuadrat e interesuara mund të paraqiten deri në orën 12:00 të premten te Krenar Qelaj. Zyrtarët e kësaj federate të martën janë pritur nga Faton Kurshumlija, komesar i Garave të FBK-së, i cili ka konfirmuar mbështetjen e Federatës së Basketbollit të Kosovës për këtë turnir.

Barça interesohet për Wernerin

Skuadra e Barcelonës është duke u përgatitur që të përforcohet në fazën e sulmit në afatin kalimtar të janarit. "ESPN" raporton se Timo Werner është synim i klubit spanjoll. Reprezentuesi i Gjermanisë nuk po gjënë hapësirë në skuadrën e Chelseat, pasi zgjedhja e parë është Lukaku, derisa në Barcelonë do të kishte më shumë hapësirë, prandaj ky transferim duket i mundshëm.

Ibra: Faullin ndaj Azpilicuetas e bëra me qëllim

Sulmuesi i AC Milanit, Zlatan Ibrahimoviq, ka folur rreth faullit që ka bërë ndaj mbrojtësit të Spanjës, Cesar Azpilicueta. Sulmuesi suedez e ka pranuar se e ka goditur mbrojtësin kundërshtar me qëllim. "E bëra me qëllim. Nuk është turp të thuhet se ai bëri diçka ndaj një lojtari tim. E bënte të madhin kundër lojtarit tim. Nuk kishte t... ta bënte kundër meje. Nuk mund të sulmosh një qen që nuk flet. Sulmoje atë që është në gjendje të bëjë diçka. Është lehtë të zgjedhësh bashkëlojtarin që është 20 vjet dhe shumë djalë i mirë. Shpresoj që ta kuptoj këtë. Do ta bëj sërish. 100 për qind", ka thënë Ibrahimoviqi.

Osimheni operohet me sukses, rikthehet pas tre muajsh

Sulmuesi i Napolit, Victor Osimhen, është operuar me sukses të martën, por koha e shërimit do të jetë shumë më e gjatë sesa ishte parashikuar fillimisht. Sulmuesi është mirë dhe do të qëndrojë nën vëzhgim për disa ditë. Parashikohet që ai të rikthehet në dispozicion të trajnerit Spalletti pas rreth 90 ditësh. Duke llogaritur tre muaj të plotë, rikthimi do të bëhej në një nga këto ndeshje Cagliari - Napoli më 20 shkurt, dueli i kthimit ndaj Interit (13 shkurt) dhe ndeshjeve kundër Lazios (27 shkurt) dhe Milanit (6 mars). Vetë sulmuesi priste që të luante me kombëtaren e Nigerisë në Kupën e Afrikës, por edhe ky opsion duket se është shuar.

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo -Tax Administration of Kosovo

Njoftim për tatimpagues

Regjistroni veprimtaritë ekonomike dhe deklaroni të punësuarit tuaj!

Administrata Tatimore e Kosovës, rikujton të gjithë personat të cilët merren me aktivitete afariste, se në bazë të legjislacionit tatimor janë të detyruar të regjistrohen, pajisen me Numër Unik Identifikues / Numër Fiskal, deklarojnë dhe paguajnë tatimet (bazuar në statusin e tyre) dhe të mbajnë Tatimin në Burim dhe Kontributet Pensionale për punëtorët e tyre. Po ashtu, ATK, rikujton të gjithë personat që zhvillimin e veprimtarisë ekonomike ta kenë në harmoni me Kodin e Veprimtarive Ekonomike NACE Rev.2, si dhe të kenë të hapura llogaritë përkatëse tatimore.

Disa nga tatimpaguesit me veprimtaritë në vijim, nuk zbatojnë këtë obligim, prandaj ATK u bënë thirrje që të regjistrohen apo përditësojnë të dhënat e tyre sa më parë dhe të përmbushin të gjitha obligimet tatimore të parapara me legjislacionin tatimor.

Gjithashtu ATK, ju njofton se aktivitetet e saj, do të përqendrohen pikërisht te këto veprimtari, prandaj, ju inkurajon që t'i përgjigjeni detyrimeve tatimore, në mënyrë që të mos bëheni subjekt i ndëshkimeve të përcaktuara me Ligj.

Ndërtimtaria	Tregtia	Shërbimet profesionale, artistike dhe zbavitëse	Patundshmëritë / Qiradhënësit	Agrikulturë dhe mineraleve	Punëdhënësit që nuk deklarojnë punëtorët
Bizneset, grupet punuese dhe personat fizikë në kuadër të veprimtarisë së ndërtimtarisë, si: Muratorët, Armaturë punuesit, Betonime, Gërmimet e dheut, Punuesit e kulmeve, Prodhimi dhe montimi i dyerve dhe dritareve, Elektricistët, Instaluesit e ujit dhe ngrohjes qendrore, Montuesit e parketit/laminatit, Montuesit e qeramikës, Suvatuesit – fasada, Prodhimi dhe montimi i olluqeve, rrethojave të ballkonëve, shkallëve dhe rrethojave të oborreve nga metalet e ndryshme dhe druri, etj.	Bizneset dhe personat fizikë të cilët merren me aktivitete tregtare të mallrave të konsumit të gjerë, teksilit, etj.	Avokatët - Noterët, Kontabilistët, Këngëtarët, Internet kafetë, Zyrat që ofrojnë shërbime konsulente, Shërbimet e ndryshme elektronike, Floktarët/Sallonet e ondulimit, Rrobaqepësit, Piktorët, Kompozitorët si dhe personat fizik të cilët merren me veprimtari artistike, siç mund të jenë industritë muzikore, etj. Zyrat projektuese – arkitektët, Bizneset dentare, etj.	Personat fizikë dhe bizneset të cilët lëshojnë objekte afariste apo banesore me qira.	Bizneset dhe personat fizikë të cilët merren me kultivimin dhe tregtimin e pemëve dhe perimeve, Kultivuesit e serave të ndryshme, Fermerët e ndryshëm në blegtori dhe shpezëtari, Plantazhet, Gurëthyesit, Tregtarët e rërës, Eksploatuesit e ndryshëm të mineraleve, etj.	Të gjithë punëdhënësit që nuk deklarojnë punëtorët e tyre dhe nuk mbajnë Tatimin në Burim dhe Kontributet Pensionale për ta.

Me kryerjen e detyrimeve tuaja tatimore, ju kontribuoni direkt në ofrimin e shërbimeve publike, arsimim me standarde të larta, shërbime më të mira shëndetësore dhe sociale, mbrojtje ligjore dhe siguri, si dhe infrastrukturë të përgjithshme për një mirëqenie të qëndrueshme ekonomike dhe shoqërore.
Regjistrohu, Deklaro dhe Paguaj Tatimet!

Administrata Tatimore e Kosovës

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Feride Marmullaku shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

▶ Eljesa Gjemollari shpall te pavlefshme dëftesat e kl I- V dhe VI - IX shfmu " Fadil Hisari " Prizren.

▶ Endrit Zekaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Deshmoret e Kabashit " Korishe.

▶ Edisona Bajra shpall te pavlefshme deftesat e kl VI - IX shfmu " Aziz Tolaj " Prizren.

▶ Qemajl Kurhasku nga Cermjani Gjakovës shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të SH.F.M.U. "Ali Hasi" Cermjan nga kl. I deri ne V dhe VI deri IX.

▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se N.T. "K&K-Company" SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 810362054 dhe numër fiskal: 600032502, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa N.T. "K&K-Company" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nr. 810362054 i fiskalnom broja: 600032502 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the N.T. "K&K-Company" L.L.C. has come to the decision to quit its business: nr. 810362054 i fiscal number: 600032502 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

ROYAL CROWN
RC cola

ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

RC cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L

MEKA
HALAL FOOD
PASHTETË PULE
gluten free
100 % mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues